

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN GRADISHTË, LUSHNJE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **komunën Lushnje**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 12, datë 20.02.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1149/7, datë 13.3.2015, i ka rekomanduar z. Fatos Tushe, Kryetar i Bashkisë Lushnje(njësi administrative), zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje: Në Komunën Gradishtë funksionon arka në lekë. Të gjitha arkëtimet e të ardhurave nga tarifat vendore dhe tatim taksave bëheshin nëpërmjet arkës. Derdhjet e vlerave monetare në banke nuk bëheshin për çdo raste kur tejkalohej vlera e akumuluar mbi 10,000 lekë, por bëheshin në mënyre periodike njëherë në 10 apo 15 ditë, duke shkelur kështu limitin e mbajtjes dhe ruajtjes së vlerave monetare në arkë, Trajtuar më hollësisht në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit.

Rekomandojmë: Të mos mbahen vlerave monetare në arkë mbi limitin e përcaktuar prej 10, 000 lekë dhe derdhjet në bankë të bëhen për cdo rast kur tejkalohej limiti i caktuar.

Menjëherë

2.Gjetje: Në disa raste praktikat e blerjeve me vlera të vogla nuk ishin plotësuar me dokumentacionin përkatës si: urdhra prokurimi, fondin limit, preventivat e punimeve dhe akt marrja në dorëzim. Po kështu në shumicën e rasteve të gjitha faturat e furnitorëve ishin fatura të thjeshta tatimore dhe disa prej tyre nuk ishin plotësuar me të gjitha ekstremet përkatëse.

Rekomandim: Komuna Gradishtë të plotësojë praktikat e blerjeve me vlera të vogla me dokumentacionin përkatës sipas rregullave të prokurimit publik.

Në vijimësi

3.Gjetje: Komuna Gradishte ka në pronësi dhe në administrim tre rrjete ujësjellësi dhe për mbajtjen në punë të këtyre ujësjellësve nga buxheti i komunës, janë planifikuar të ardhura dhe janë kryer shpenzime. Të ardhura nga prodhimi dhe shitja e ujit janë arkëtuar në nivel të ulët, çka tregon për një keq menaxhim të punës të ujësjellësit, e për pasojë është krijuar një humbje e konsiderueshme për buxhetin e Komunes. Kjo situatë problematike, përveç se ka ardhur nga rrjeti teje i amortizuar apo i dëmtuar, ka ardhur edhe nga mos mbledhja e faturave të ujit si dhe humbjet apo vjedhjet në rrjetin e ujësjellësit. Gjithashtu, Komuna përveç se ka në administrim këtë ujësjellës, në zbatim të VKM nr. 660, datë 12.09.2007 “Për transferimin aksioneve të shoqërive të Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes Vendore”, është njëkohësisht edhe aksionare në Ujësjellësin, Fshat të Lushnjës (SH.A), me 10.2 % të aksioneve të saj. Del qartë se pjesëmarrja si aksionare në këtë shoqëri jo vetëm që nuk ka dhënë rezultate ekonomike pozitive për Komunën, por ka përkeqësuar buxhetin e saj, trajtuar më hollësisht në faqet 39-40, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit.

Rekomandimi. Komuna Gradishtë të marrë masa e ti kërkoje Ujësjiellësit, Fshat Lushnjë që tre ujesjiellat në pronësi dhe administrim të Komunës të kalojnë në administrim të kësaj SH.A

Brenda muajit mars 2015

4.Gjetje:-Nuk janë përgatitur dhe dorëzuar në APP, regjistrat e realizimit të prokurimeve periodike dhe vjetore të viteve 2012 dhe 2013 dhe regjistri i realizimit të prokurimeve periodik të 4 mujorit të parë të viti 2014, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Në procedurën e prokurimi , “Shtrim me rërë bituminoze, rruga Senëz”, me fond limit në vlerën 7,969,850 lekë, dy ditë pas hapjes së ofertave është tërhequr nga tenderi bashkimi i operatoreve “S.& Sh...& Z..”. Për këtë tërheqje, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, KVO nuk i ka konfiskuar këtij bashkimi operatoresh garancinë e ofertës në vlerën **159,397 leke**. Nga ky veprim përveç se, nuk është arkëtuar kjo vlerë në favor të buxhetit të Komunës, nuk është përmbushur edhe qëllimi i këtij ligji në lidhje me mirë përdorimin e fondeve buxhetore, sepse oferta e operatorit të tërhequr është me e ulët në vlerë se oferta e operatorit fitues me diferencë prej 1,499,400 leke, dhe nga kërkesa për konfiskimin e garancisë operatori ekonomik mundet të mos tërheqet nga tenderi e për pasojë kjo vlerë do të kursehet buxhetit të Komunës.

-Ne 4 procedura prokurimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin teknik të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këto procedura prokurimit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” duhet të kërkonte nga operatorët ekonomik, sqarime për këto mangësi për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me rregullave të prokurimit publik nuk është përmbushur qëllimi i këtij ligji në lidhje me mirë përdorimin e fondeve buxhetore, duke mos i kursyer buxhetit të Komunës fonde në vlerën **1,659,240 leke**.

Rekomandim: Komuna Gradishtë të përgatis dhe dorëzojë në APP, regjistrat e realizimit të prokurimeve periodike dhe vjetore.

Ne vijimësi

- Komuna Gradishtë për çdo procedure prokurimi, në dokumentet e tenderit të kontratave për mallra shërbimet dhe pune, të vendoset që operatorët ekonomik në rastet e tërheqjes nga tenderi në mënyrë të njëanshme mbas hapjes së ofertave, përveç konfiskimit të garancisë së ofertës, të kërkohej në APP të përjashtoi operatorin ekonomik nga procedurat e prokurimit për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet.

- Komuna Gradishtë në çdo procedure prokurimi dhe në rast kur konstatohen mangësi në dokumentacionin teknik të operatoreve pjesëmarrës, ti kërkohej operatorëve ekonomik sqarime për këto mangësi, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera.

Në vijimësi

5. Gjetje:- Në të gjitha dosjet teknike (për 5 kontrata) u konstatuan mangësi në mbajtjen e dokumentacionit teknik në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

-Për 3 kontrata nuk është aplikuar dëmshpërblimi për vonesat në përfundimin e punimeve në vlerën në totale 1,178,486 lekë ne kundërshtim me kushtet e kontratave të lidhura me sipërmarrësit e punimeve, konkretisht, 1 kontratë me 2 muaj e 25 ditë vonesë të dhe 2 kontrata me 12 ditë vonesë secila, si dhe në 1 kontratë u konstatuan volume pune të pakryera në vlerën 23,810 lekë

-Ne 3 kontrata u konstatuan mangësi në projektimin dhe në cilësinë e punimeve të cilat ka në ardhur si pasojë e specifikimeve teknike jo të sakta, veçanërisht të rërës bituminoze, shtresave me çakëll dhe me stabilizant, për të cilat nuk janë përcaktuar saktë as parametrat gjeologjikë dhe ato teknike që duhet të përmbushin pas vendosjes në vepër.

-Nga verifikimi në terren i punimeve të përfunduara për objektet, “Rikonstruksion rruge me rërë bituminoze fshati Senez L=2450 ml” dhe “Shtrim Rruga e Korijes L=1000 ml + 500 ml dhe fshati Goriçaj L=450 ml me rërë bituminoze”, u vërejtë se rrugët ishin tejet të amortizuara. Në veçanti rruga “Rikonstruksion rruge me rërë bituminoze fshati Senez L=2450 ml” nuk është ndërtuar sipas kushteve të kontratës pasi nuk është respektuar sipas projektit trashësia e shtresës bituminoze prej 10 cm në aks të rrugës dhe në pjesët anësore të saj, duke bërë që shtresa bituminoze të mos ruante uniformitetin në trashësi përgjatë trupit të rrugës, trajtuar më hollësisht në faqet 54-61, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit.

Rekomandim: Komuna Gradishtë për të dyja investimet me objekt “Rikonstruksion rruge me rërë bituminoze fshati Senez L=2450 ml” dhe “Shtrim Rruga e Korijes L=1000 ml + 500 ml dhe fshati Goriçaj L=450 ml me rërë bituminoze” të kryej analiza laboratorike në laboratorë të certifikuar për të përcaktuar përmbajtjen e shtresave në trupin e rrugës dhe shtresat në bankina. Me garancinë e cilësisë së materialeve të përdorur në trupin e rrugës, grupi i marrjes në dorëzim të sigurojë se rruga është realizuar në përputhje me projektin, është realizuar pjerrësia 2 % (kurriz peshku), nuk ka gropëzime, nuk ka valëzime dhe e gjithë kjo të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm teknik e fotografik për të gjithë gjatësinë e rrugës.

Menjëherë

Komuna Gradishtë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për të përcaktuar specifikimet teknike që duhet të përmbushin materialet e përdorura në investimet e mësipërme, si dhe parametrat që duhet të plotësojë rruga pas përfundimit të punimeve (provat nën ngarkesë, dendësia etj) në përputhje me praktikën më të mirë apo të huaja për këto procese.

Menjëherë

Komuna Gradishtë, të marrë masa që në momentin e dorëzimit të dosjes teknike nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, të kryej verifikimet e nevojshme për dokumentacionin e duhur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

6.Gjetje: Gjate periudhës janar 2012 deri me 30.06.2014, janë evidentuar edhe 21 ndërtime të tjera pa leje nga të cilat 8 ndërtesa janë për banesa dhe 13 janë për biznese. Nga inspektori i Komunës, për secilën nga këto ndërtime janë mbajtur procesverbal konstatimit dhe në mungesë të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës, me shkresë të datës 10.10.2014 është vënë në dijeni dhe është kërkuar bashkëpunimi me Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Qarkut Fier për prishjen e këtyre objekteve. Ky Inspektorat ka ndërhyrë duke bërë njoftimet përkatëse për çdo objekt të ndërtuar pa leje, por deri në momentin e auditimit, nuk është bërë e mundur

prishja e tyre, trajtuar më hollësisht në faqet 65-67, të Raportit Përfundimtarë të Auditimit.

Rekomandim:

Rekomandimi. Komuna Gradishtë të vazhdojë bashkëpunimin me Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të Qarkut Fier për zbatimin e procedurave ligjore për vlerësimin e objekteve të ndertuara pa leje ndërtimi .

Në vijimësi

7.Gjetje: Në zbatim të VKM nr. 948 dt.02.09.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim" Komunës Gradishte, i janë transferuar 294 prona të paluajtshme publike në pronësi ose në përdorim të saj . Për një pjesë te pronave, për te cilat ka menduar se përbejnë burim te ardhurash, ka kryer procedurat e regjistrimit te tyre pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, Lushnje, ndërsa për pjesën tjetër të pronës që i është transferuar për mungese financimi nuk kanë vazhduar procedurat e regjistrimit.

Rekomandojmë: Komuna Gradishtë, të gjenden burimet e financimit për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të regjistrimit të të gjitha pronave te Komunës.

Në vijimësi

8.Gjetje: Në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera te pasurisë shtetërore" i ndryshuar, dhe ne zbatim të ligjin Nr. 8312 , datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Komuna Gradishtë gjatë vitit 2013, ka dhëne me qira:

1. Një pjesë nga sipërfaqja e katit të parë të ndërtesës së "Qendrës Shëndetësore të fshatit Këmishtaj" të ndarë në 6 pjesë. Këto ambiente bazuar në këtë VKM janë dhëne me qira pa konkurrim me afat një vjeçar. U konstatuan shkelje në lidhje me plotësimin e dokumentacionit nga disa subjektet qiramarrëse pasi nuk kishin paraqitur: NUIS-in dhe vërtetimi nga dega e tatimeve së subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore. Vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka procese gjyqësore, Certifikata e regjistrimit dhe certifikatën historike të subjektit ne QKR.

8.2. Një pjesë me sipërfaqe 706.31 m2 te objektit te "Pallati i Kulturës Këmishtaj është dhëne me qira (enfiteozë). Komisioni për përcaktimin e vlerës së investimi të kësaj ndërtese ka përcaktuar një vlerën e investimit prej 13,991,895 lekë si minimum i domosdoshëm për të bërë funksionale këtë qendrën kulturore. Në dokumentacionin e konkurrimit është vendosur kriteri që ky investim do ti njihet qiramarrësit duke ja zbritur këtë vlerë nga detyrimi i tarifës së qirasë. Ne kontrate është vendosur që nga detyrimi vjetor prej 932,328 lekë do te zbritet vlere vjetore e investimit prej 699,588 leke dhe detyrimi vjetor i qirasë do të jetë 232,740 lekë. Vendosja e këtij kriteri në dokumentet e konkurrimit dhe në kontratën e qirasë është në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar me VKM nr 54, date 05.02.2014. Nga ky veprim, vetëm për vitin 2014 i është shkaktuar buxhetit të Komunës dëm ekonomik në vlerën 699,588 lekë (932,328 -232,740). Po kështu nga zbatimi i kontratës deri në përfundim të afatit prej 20 vjet do të rezultoi një dëm ekonomik ne vlerën 13,991,760 leke (699,588 lekë x20 vjet).

(Duhet theksuar se, mbas mbajtjes së procesverbalit nga auditimi ky dëm është arkëtuar nga subjekti qiramarrës. Gjithashtu ky subjekt është tërhequr zyrtarisht edhe nga Kontrata e Qirasë)

8.3. Ne dy raste Komuna Gradishtë ka dhënë me qira 2 hektar toke bujqësore te ndara nga 1 një hektar secila. Ne përfundim te konkurrimit jane shpallur fituesin subjektet, “S...P” dhe “G..M”. Me te dy këto subjektet janë lidhur kontratat e qirasë, te cilat rreth 2 deri ne 4 muaj me vone jane noterizuar me aktet noteriali perkatese. Te dy kontratat kane për objekt kultivimin e ullirit dhe janë lidhur me afate 99 vjeçar bazuar UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “ Për procedurat e dhënies me qira te tokave bujqesore te pandara”. Këto kategori tokash para se te jepen me qira duhet te pajisen me certifikatën e pronësisë dhe për këtë, Komuna para se të fillonte procedurën e konkurrimit duhet të kërkonte nga ZRPP marrjen certifikatës së pronësisë të këtyre sipërfaqeve. Por, mbas organizimit të konkurrimit dhe shpalljes së fituesve, Komuna i ka kërkuar ZRPP regjistrimin e këtyre sipërfaqeve për të marrë certifikatën e pronësisë. ZRPP me shkresë 500/1, datë 25.11.2014 i ka kthyer përgjigje Komunës, “nuk ka një format për certifikata në përdorim për rrjedhoje nuk mund të regjistrohen pasuritë në përdorim”. Mos pajisja me këtë certifikatë pronësie, është shkaku i vonesave të noterizimit të kontratave, të cilat janë noterizuar rreth 2 deri 4 muaj me vonesë.

-Për parcelen me nr. kad 444 me sipërfaqe 1 h, Komisioni i Konkurrimit nuk beri vlerësime, sepse, 2 nga 3 ofertuesit kishin paraqitur kërkesa për marrjen me qira te një sipërfaqe tjetër toke dhe jo asaj te shpallur për konkurrim. Kjo pike e UKM bie ne kundërshtim me pikën 1 te Udhëzimin e Ministrit te Bujqësisë nr.10, date 13.09.2012, “Për mënyrën e përlllogaritjes se kriterëve te vlerësimit te ofertave për marrjen me qira te tokës bujqësorë te pandare”.

Rekomandim: Të gjitha praktikat (dosjeve) e dhënieve me qira me afat një vjeçar të plotësohen me dokumentacionin përkatës të përcaktuar në aktet ligjore e nenligjore ne fuqi, në të kundërt të kërkohet në rruge ligjore ndërprerja e kontratave dhe e mos rinovimin e tyre për periudhat në vazhdim.

Në vijimësi

-Komuna Gradisht, të bëjë të mundur gjetjen e burimit të financimit për rikonstruksionin e objektit “Pallati i Kulturës Këmishtaj”, ose në rast të dhënies me qira të ketij objekti, procedura e konkurrimit dhe njohja e vlerës së investimit të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Në vijimësi

- Komuna Gradishtë te marre masa dhe ne bashkëpunim me Ministrinë se Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave, të bëjë rregullimin për të harmonizuar pikën 1 të Udhëzimin e Ministrit te Bujqësisë nr.10, date 13.09.2012, “Për mënyrën e përlllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësorë të pandare” me pikën 5, kreu II të Udhëzimit të Këshillit te Ministrave nr. 1, datë 18.07.2012“ Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësorë të pandara”

Menjëherë

9.Gjetje:Në përgjithësi nuk njihet dhe nuk ka gjetur zbatim Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, trajtuar më hollësisht në faqet 12-15, të Raportit Përfundimtarë te Auditimit.

Rekomandim:Të përgatitet “Deklarata Vjetore mbi Funkcionimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar, të hartohen gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga Ministria e Financave, të hartohet Strategjia e Menaxhimit të Risqeve, dhe të përmbushen

detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve.

Menjëherë

Të hartohet “Kodi Etik, dhe Rregullore të Brendshme e funksionimit te institucionit në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të merren masa për ti kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën 159,397 lekë Komisionit te Vleresimet te Ofertave duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative. Sepse, KVO ka vepruar ne kundërshtim me rregullat e prokurimit publik ne tenderin “Shtrim Rruga Senëz me rërë bituminoze”, me fond limit ne vleren 7,969,850 lekë, pasi bashkimi i operatoreve “S...&Sh...07& 2Z C” pjesëmarrës në këtë tender dy ditë pas hapjes se ofertave është tërhequr nga tenderi e per pasoje duhej ti konfiskohej dhe te arketohej per llogari te buxhetit te Komunes garancia e ofertës ne vlerën 159,397 leke.

Brenda muajit mars 2015

2. Të merren masa për ti kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën 461,875 lekë, shoqërisë sipërmarrëse “A...” dhe “G...G”, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative. Kjo vlere perfaqeson dite vonesat ne përfundimin e punimeve në zbatim te kontratës sipërmarrësjes te lidhur ne datë 07.06.2013 per “Shtrimin e rruges me asfalt te fshatit Sopez me gjatesi 50 ml, faza II”.

Brenda muajit mars 2015

3. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën 377,496 lekë, shoqërisë sipërmarrëse “A.... dhe G.....G”, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative. Kjo vlere përfaqëson dite vonesat ne përfundimin e punimeve në zbatim te kontratës sipërmarrësjes te lidhur ne datë 27.06.2014 per “Rikonstruksionin e rruges me rërë bituminoze te fshati Senez me gjatësi 450 ml” .

Brenda muajit mars 2015

4. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën 339,112 lekë, shoqërisë sipërmarrëse “A....” duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative. Kjo vlere perfaqeson dite vonesat ne përfundimin e punimeve në zbatim te kontratës sipërmarrësjes te lidhur ne datë 27.08.2012 per “Rikonstruksionin e rruges se fshatit Sopez me gjatesi 375 ml, faza I”.

Brenda muajit mars 2015

5. Të merren masa për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën 23,810 lekë shoqërisë sipërmarrëse “S...” duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative. Kjo vlere perfaqeson punime të pakryera dhe te paguara gjate zbatimit te kontratës sipërmarrësjes te lidhur ne datë 24.06.2014 per “Ndërtimin e Ures HD-3 m, Gj=5m, Fier Seman”.

Brenda muajit mars 2015

C. MASA ADMINISTRATIVE.

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, komuna t’i

kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Qarkut Fier pranë Këshillit të Qarkut Fier, të vendosë gjorbë për mbikëqyrësen e punimeve të ndërtimit, z. Rr.B, sepse:

- Me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në 5 dosjet teknike (kontrata) të mbajtura prej tij u konstatuan mangësi në mbajtjen e dokumentacionit teknik në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

- Me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për 3 kontrata nuk është kërkuar pranë Komunës aplikimi dhe mbajtja e dëmshpërblimit për vonesat në përfundimin e punimeve në vlerën në totale 1,178,486 lekë në kundërshtim me kushtet e kontratave të lidhura me sipërmarrësit e punimeve, konkretisht, 1 kontratë me 2 muaj e 25 ditë vonesë të dhe 2 kontrata me 12 ditë vonesë secila, si dhe në 1 kontratë u konstatuan volume pune të pakryera në vlerën 23,810 lekë

- Me cilësinë e projektuesit, të hartimit të dokumenteve të tenderit dhe të mbikëqyrësit të punimeve, në 3 kontrata u konstatuan mangësi në projektimin dhe në cilësinë e punimeve të cilat ka në ardhur si pasojë e specifikimeve teknike jo të sakta, veçanërisht të rërës bituminoze, shtresave me çakëll dhe me stabilizant, për të cilat nuk janë përcaktuar saktë as parametrat gjeologjikë dhe ato teknike që duhet të përmbushin para dhe pas vendosjes në objekt.

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 germa “i” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore,

• **“Vërejtje me shkrim”, për:**

1. Z. P., me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës

2. Z. K.K me detyrë teknik ndërtimi

Këta punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sepse:

-Në procedurën e prokurimi, “Shtrim me rërë bituminoze, rruga Senëz”, me fond limit në vlerën 7,969,850 lekë, dy ditë pas hapjes së ofertave është tërhequr nga tenderi një operatore ekonomik dhe për këtë tërheqje, nuk i është konfiskuar garancia e ofertës në vlerën **159,397 leke**. Në 4 procedura prokurimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin teknik të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe nuk u është kërkuar këtyre operatorëve sqarime për këto mangësi për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprimeve nuk është përmbushur qëllimi i këtij ligji në lidhje me mirë përdorimin e fondeve buxhetore, duke mos i kursyer buxhetit të Komunës fonde në vlerën 1,659,240 leke.

-Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave, në konkurrimit për dhënien me qira të sipërfaqes prej 706.31 m² të objektit të “Pallati i Kulturës Këmishtaj” kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitoaze apo

kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si pasojë i është shkaktuar buxhetit të Komunës dëm ekonomik në vlerën 699,588 lekë, dëm të cili mbas konstatimit të auditimit, subjekti qiramarrës e ka arkëtuar në arkën e Komunës.

• **“Vërejtje”, për:**

1. Z. I.N me detyrë arkëtar,

Ky punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sepse:

Në procedurën e prokurimit, “Shtrim me rërë bituminoze, rruga Senëz”, me fond limit në vlerën 7,969,850 lekë, dy ditë pas hapjes së ofertave është tërhequr nga tenderi një operatore ekonomik dhe për këtë tërheqje, nuk i është konfiskuar garancia e ofertës në vlerën **159,397 leke**. Në 4 procedura prokurimi janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në dokumentacionin teknik të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe nuk u është kërkuar këtyre operatorëve sqarime për këto mangësi për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera. Si pasojë e këtyre veprimeve apo mosveprimeve nuk është përmbushur qëllimi i këtij ligji në lidhje me mirë përdorimin e fondeve buxhetore, duke mos i kursyer buxhetit të Komunës fonde në vlerën 1,659,240 leke.

2. Z.M.M, me detyrë përgjegjës i Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës,

- Ky punonjës, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ofertave, në konkurrimin për dhënie me qira të sipërfaqes prej 706.31 m² të objektit të “Pallati i Kulturës Këmishtaj ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si pasojë i është shkaktuar buxhetit të Komunës dëm ekonomik në vlerën 699,588 lekë, dëm të cili mbas konstatimit të auditimit, subjekti qiramarrës e ka arkëtuar në arkën e Komunës.

KALLZIM PENAL

Në mbështetje të nenit 10 dhe 15 germa “gj”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnje, Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe materialet e tjera shoqëruese, për vlerësim dhe fillimit të hetimit për konsumimin e elementëve të veprës penale nga drejtuesit e komunës Gradishtë, Lushnje.

Nga Komuna Gradishtë, nuk është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet nuk janë zbatuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Harizi, Rezart Golemi dhe Jonild Hoxha, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

